



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sporteve, rr. Ramiz Sadiku Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com

Ftesë për ofertë për furnizim me pajisje të pingpongut

Numri i protokollit: 2026-.....

Data: 03/08/2026

Emri i projektit: "Furnizim me pajisje sportive të pingpongut"

Për: Kompanitë vendore dhe ndërkombëtare të specializuara për pajisje të pingpongut

Afati: 15 gusht 2026, ora 16:00

Buxheti i parashikuar: 32,000.00 €

I. Ftesa për Ofertë

Federata e Pingpongut e Kosovës (FPPK) fton të gjitha kompanitë e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre financiare dhe teknike për furnizimin me artikujt e mëposhtëm:

- 30 tavolina të aprovuara nga ITTF (25 mm ose 28 mm, me rrota).
- 300 paravanë të fushës së pingpongut (233 cm x 70 cm).
- 50 kuti me topa (me 1 yll, 40+ mm, të aprovuar nga ITTF, me nga 100 topa në kuti).

II. Dokumentacioni i kërkuar

Ofertës suaj duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (për kompani vendore) apo dokumenti ekuivalent (për kompani të huaja).
2. Certifikatë zyrtare që vërteton se tavolinat dhe topat janë "ITTF Approved".
3. Katalogë, broshura apo specifikime teknike zyrtare për artikujt e ofertuar.
4. Afati i saktë i dorëzimit të mallit (i shprehur në ditë kalendarike).

III. Udhëzimet për dorëzimin e ofertës

- **Afati i fundit për dorëzim:** Data 15.08.2026, Ora 16:00.
- **Mënyra e dorëzimit:** Ofertat duhet të dërgohen në formë elektronike (PDF) me e-mail në adresën zyrtare të FPPK-së: info@fppk.com
- **Valuta:** Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Euro (€). Për kompanitë vendore çmimi duhet të përfshijë TVSH-në, ndërsa për kompanitë e huaja të specifikohet baza e çmimit (p.sh. CIP Prishtina).
- **Vlefshmëria e ofertës:** Oferta duhet të jetë e vlefshme të paktën 30 ditë nga afati i fundit i dorëzimit.

IV. Kushtet e pagesës dhe garancia

- **Pagesa** do të realizohet me transfer bankar brenda 15 ditëve pas pranimit të plotë të mallit dhe faturës zyrtare.
- **Mallrat e dëmtuara** gjatë transportit ose që nuk përputhen me specifikimet do të zëvendësohen nga furnizuesi pa asnjë kosto shtesë për FPPK-në.

V. Vlerësimi i ofertave dhe dhënia e kontratës

Vlerësimi do të bëhet nga Komisioni i Vlerësimit i FPPK-së. Kontrata do t'i jepet ofertuesit administrativisht të përgjegjshëm, që plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe ofron çmimin më të ulët total.

VI. Tabela e Ofertës Financiare dhe Teknike

(Ofertuesi duhet ta plotësojë tabelën e mëposhtme. Në rast devijimi ose specifikimi shtesë të brendit, të shënohet te kolonat përkatëse).

Nr.	Përshkrimi i artikullit	Specifikimi Teknik i kërkuar	Brendi / Modeli	Njësia	Sasia	Çmimi Njësi	Total (€)
1	Tavolina pingpongu	• ITTF Approved • Trashësia 25 mm ose 28 mm • Me rrota për zhvendosje		copë	30		
2	Rrjeta të tavolinës së pingpongut	• ITTF Approved		copë	30		
3	Paravanë fushash	• Përmasat: 233 cm x 70 cm • Me kornizë metalike dhe pëlhurë		copë	300		
4	Kutitë me topa	• Me 1 yll (për ushtrime) • ITTF Approved (40+ mm) • 100 topa/kuti		kuti	50		
	TOTALI (€)						

Emri i Kompanisë: _____

Përfaqësuesi / Nënshkrimi: _____

Vula: _____ Data: __ / __ / 2026